

Vehbi KADRIU

Gjuha shqipe



Viti shkollor 2022/2023

Gjuha shqipe 1

viti shkollor 2022/2023

Autor: Vehbi KADRIU

Konceptoi strukturën e tekstit dhe u kujdes për zbërthimin didaktik:

Rita PETRO

Mirela TEROVA

Recensentë:

Zeqir KADRIU

Hatixhe TOPALLI

Salije MIFTARI

Botues: Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, 1000 Shkup

Kryeredaktore: Natasha PEPIVANI

Redaktore: Ervisa PALOKA

Redaktor profesional: Refail SULEJMANI

Lektor: Medina MEHMETI

Rregullimi grafik dhe teknik: Evgenija PAVLLOVA – ARS STUDIO

Kopertina: Eva KUKALESHI

Ilustruese: Ledia KOSTANDINI

Shtypi: EVROPA 92 – Koçan

Tirazhi: 6.663

Vendi dhe viti i botimit: Shkup, 2022

Me vendim për miratimin e tekstit mësimor në lëndën Gjuha shqipe për klasën e parë nr. 26-1466/1 të datës 18.10.2022 i miratuar nga Komisioni kombëtar i teksteve mësimore.

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

373.3.016:811.18(075.2)

KADRIU, Vehbi

Gjuha shqipe 1 : viti shkollor 2022/2023 / Vehbi Kadriu ;
[Ilustruese Ledia Kostandini]. - Shkup : Ministria për arsim dhe shkencë
e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2022. - 131 стр. : илустр. ; 28 см

ISBN 978-608-273-170-4

COBISS.MK-ID 58702085

E dashur nxënëse,
I dashur nxënës,

Ky do të jetë një tekst shumë
i dashur për ty.

Ti do të mësosh të lexosh dhe të
shkruash në gjuhën e bukur shqipe.

Në këtë tekst do të miqësohesh
me katër personazhet e librit: Anën,
Lulin, qenin Bubi dhe robotin Roki.

Së bashku me to do të argëtohesh
dhe do të mësosh gjëra të reja e
interesante.


Ditëlindja

1. Trego çka po sheh në figura. Pse po festojnë?




Viti i Ri

1. Rretho vetëm festën e Vitit të Ri.




2. Ngjyros kartolinën e Vitit të Ri dhe miushin e gëzuar.



Çfarë di të bësh?


1. Thuaj çfarë dinë të bëjnë fëmijët në figurat e mëposhtme.



2. Rretho çfarë të pëlqen ty.

Lojërat më të bukura

1. Rretho lojërat që luan edhe ti.





2. Ngjyros.




Shoqërimi

1. Rretho shokët e përbashkët.



Hija e kafshëve




1. Lidh me shigjetë kafshët me hijet dhe ngjyrosi.



Lojë me numra

1. Mblidh duke bashkuar grupet.

Qenushi do të shkojë me pushime.
Ai po bën gati valixhet.
Ndhmoje dhe ti.



Bisedë për ndjenjat

1. A e gjeni se çfarë shprehin fytyrat e fëmijëve?



Khuxhët dhe Borëbardha

1. Dëgjoni pjesën dhe tregojeni me fjalët tuaja.

Borëbardha jetonte në shtëpinë e shtatë xhuxhëve. Një ditë njerka e keqe u vesh si plakë dhe shkoi në shtëpinë e xhuxhëve. Ajo i dha Borëbardhës një mollë të kuqe. Vajza u helmua nga molla. Kur xhuxhët po qanin, erdhi princi dhe e puthi. Borëbardha u zgjua. Ata u martuan e jetuan të lumtur.



2. Vizato sendet që mungojnë për 7 xhuxhat.



Po të qeshin të gjithë fëmijët

Po të _____ gjithë fëmijët
e _____ i tyre të vërshojë në botë,
skamje s'do të ketë, as _____,
s'do të ketë as _____, as lot.

Po të qeshin gjithë _____,
do të _____ kufijtë dhe shtetet,
do të lulëzojnë _____ në dimër,
dashuria midis _____ do të mbetet.

Xhani Rodari



Miqtë tane



Unë jam Ana.


Ham - ham
Jam Bubi.



Miqte tanë

Ro ki

Unë jam Luli.



Në shtëpi



OXHAK



KOMPJUTER



PERDE



RAFT



DRITARE





TELEVIZOR



ORË



LLAMBË



PIKTURË



KARRIGE



TAVOLINË



DERË



LULE

Në dyqan



BUKË



MOLLË



QUMËSH



DOMATE



DJATHË



VEZË




ANANAS



KAROTË





SHALL



XHAKETË



BLUZË



KAPUÇ



RRIP



PANTALLONA



ÇORAPË



FUSTAN



SANDALE



KËPUCË

Në qytet



SHKOLLË




SEMAFOR



NDËRTESE



KOSH



TROTUAR





VIJA TË BARDHA



AUTOBUS



SHTYLLË



POLIC



DYQAN



VETURË



MOTOR

Në fshat



SHTËPI



MACE



TRAKTOR



KALË



PULË



PUS





FUSHË



GARDH



KODËR



LOPË



DELE



GOMAR



KOLIBE



GJEL

Rokú

A B C C D D H E


Ë F G G J H I J K L

L M N J O P Q R

R R S S H T T H U

V X X H Y Z Z H

shkruan dhe lexon





Unë jam **A**na.
Unë kam **a**ri.

A na
a ri



1. Kërko **A** (**a**). Sa ke gjetur?

mami	babi	nëna	Albana	6
arra	molla	dardha	qepa	
autobusi	ambulanca	makina	biçikleta	
delja	papagalli	luani	ham-ham	

2. Shkruaj shkronjën **A** (**a**):



_ KULLORJ _

_ kullorj _



_ EROPLANI

_ eroplani



_ N _ N _ SI

_ n _ n _ si



M _ CJ _

m _ cj _

3. Rretho figurat ku dëgjon A.



4. Plotëso:



ka vel _ .


_ nij _ _ _



5. Gjej jam:

anakam jam marnijamananasjamakamjamranijamamakam

6. Ngjyros.






Macja ime Mimi.
Macja bën mjau-mjau.



Ma ce
Mi mi
mjau



1. Rretho M në etiketa:



Mbushe pjatën me makarona.



2. Shkruaj shkronjën M (m):



_ OLLA

_ URI

LI _ ONI

LU _ I

_ olla

_ uri

li _ oni

lu _ i


3. Gjej **M** (m):

Miki Mausin është një mi,
shumë i mirë e simpatik.

A e njihni ju fëmijë?

Unë e kam shumë mik.

Ngjyros Miki Mausin.



4. Plotëso **M** (m):

Ma _ i

_ ami mat

Ma _ i _ at me

_ a _ i mat _ e .



5. Gjej **mami**:

mo mami lium atmet mamimat murkamamiturimurimatlata

6. Ngjyros shkronjën **M** (m).

MIRËMËNGJESI!

MIRËDITA!


MIRËMBRËMA!



Iriqi, miku im.



l riq



1. Kërko l (i). Sa ke gjetur?

qilimi	litari	ylberi	<input type="checkbox"/>
kikiriku	lapsi	lliri	<input type="checkbox"/>
qielli	dielli	shiu	<input type="checkbox"/>

Vizato me l.



2. Shkruaj shkronjën l (i):



_ L _ R _

_ l _ r _



SH _ U

sh _ u



_ SHULL _


_ shull _




F _ KU


f _ ku


3. Rretho figurat ku dëgjon l (i):



4. Plotëso l (i):

l r _ qi pa 


 mori mollët.

A _ i ço _ te 

5. Gjej mi, iriq:

moll m mor i riq mamiku aririq mamiraimiririq morimollami

6. Ngjyros.





1. Rretho U (u) dhe lexo:

Ura mbi lumë.	U-ra
Luli mbi urë.	Lu-li
Lumi nën urë.	Lu-mi

2. Shkruaj shkronjën U (u):



_ JK _
_ jk _

FL _ T _ RA
fl _ t _ ra

_ LLIRI
_ lliri


RR _ SHI
rr _ shi

3. Gjej fjalën ura dhe miu.

u	r	a	r	a	u
k	u	r	a	u	r
i	a	r	k	r	a
u	r	a	b	a	q

u	b	o	m	i	u
j	a	m	i	u	u
m	i	u	k	s	j
u	j	k	m	i	u

4. Lidh me shigjetë dhe shkruaj:



u u u u u u u u

mu mu

ua ua

ciu ciu

miau

5. Plotëso:

mi
u a
U


Ma _ _ ka l _ le.

An _ k _ t _ ll _ mbace.


_ në k _ m k _ k _ ll.



6. Shkruaj dy fjalë me shkronjat në katror:



7. Ngjyros.





Ti je **r**obot.
Roboti **R**OKI.

Ro **b**o **t**i **R**o **k**i




1. Kërko **R** (**r**) dhe lexo. Sa (**R**) dhe (**r**) ke gjetur?



Roboti
Roboti Roki
Roboti Roki ra ...
Roboti Roki ra në rërë.

R	r
1	-

2. Shkruaj shkronjën **R** (**r**).



_ ADIOJA

_ OSA

DE _ A

KA _ OTA

_ adioja

_ osa

de _ a

ka _ ota

3. Lidh me shigjetë ku dëgjon:

ur

ra

or

ri



kod __



trakt __ i







ket __




lep __ i

4. Lexo dhe vizato:



5. Ngjyros.





Ej... po fryn era.



E ra



1. Rretho E (e). Lexo.


Era fryn renë.

Dielli u fsheh në re.

Shiu bie mbi pemë.



2. Plotëso E (e).



3. Rretho figurat ku dëgjon E (e).



4. Lexo dhe plotëso:



e re.



i ri.

5. Lidh rrokjet me shigjetë dhe krijo fjalë:



era _____

6. Ngjyros.

EMA ETRIT
ERZENI ERA



- Ua, natë me hënë!
- Nënë, natë me hënë!
- Natën e mirë, moj nënë!

1. Plotëso N (n):











_ ina - na _ a, Nora moj,
ni _ a - _ ana, në _ a këndo _ ,
_ ata vje _ me yje plot,
_ ora e vogël ëndërro _ .



2. Gjej nina dhe nana:

na tën in a mi r na na mo j ni na h ë na na ni na na ta





3. NUMRAT.

1		<p>Vizato 9 lule</p> 
		
		
		
		
		
		
		
9		

Në _ të _ uset ka _ ë fusta _ të bardhë.


4. Plotëso:

ni na ne nu .

			
majmu <input type="text"/>	balo <input type="text"/>	ma <input type="text"/> shaqe	tu <input type="text"/> li

5. Shkruaj:


NINA	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	NURI	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>
NAIM	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	NORA	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>



- Lule! Lule! Ua, sa lule!
- Luli, ti ke lule?
- Po, unë kam lule.
- La-la-la, luajmë me lule.



1. Plotëso L (l).

Lu _ i ka  dele.

Me lulede _ e _ uli bëri

Kurorën ia fa _ i Lu _ es.



2. Ndaj në rrokje sipas modelit:

<p>Lule</p> <p>Lu le</p>	<p>Luli</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p>	<p>Lola</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p>	<p>Lela</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p>	<p>Lili</p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p>
--------------------------	--	--	--	--

3. Lidh me shigjetë rrokjen që i takon secilës figurë.

li la lu le



Thuaj fjalë të tjera.

4. Lexo:




Luani luan me luanin.

Unë jam Luani.


Unë luaj me luanin lodër




5. Ngjyros.





1 2 3 4 5 6









1. Lexo shkronjat dhe fjalët.



2. Lidh dhe lexo:



3. Gjej fjalët dhe rretho:

mami, muri, miu, Ana, Mira, Mara, ura, ariu.

M	A	M	I	A	n	a
R	i	n	a	a	m	M
m	u	r	i	r	i	i
M	a	r	a	i	u	r
u	r	a	k	u	b	a

4. Shiko figurat dhe shkruaj fjalitë në fletore:

- Mira
- luan
- me
- Erën.





- Unë
- jam
- Miri.

- Era
- mat
- mirë.





- Luli
- ka
- mace.



Ë ndërr u në
Ë mbël si rë

Ana: Në ëndërr unë shkova në hënë.

Roki: Në ëndërr unë hëngra ëmbëlsirë.

ë ndërr u në ë mbël si rë

1. Shkruaj shkronjën Ë (ë).







_ MB _ LTORE
_ mb _ ltore

ÇEL _ S
çel _ s

ÇAD _ R
çad _ r

P _ LLUMB
p _ llumb

2. Ndaji fjalët në rrokje dhe shkronja.



3. Lexo.
 Hënë e vogël
 qan me zë
 ë - ë - ë.
 Qan me zë
 e qan me lot
 ë-ja pikat s'i ka kot.



4. Rretho sipas modelit:



i ëmbël

e ëmbël



i ëmbël

e ëmbël



i ëmbël

e ëmbël



i ëmbël


e ëmbël

5. Ngjyros.





Unë kam kompjuter.



U në jam
kom pju ter

1. Rretho K (k). Lexo.

Keli dhe Krenari shkuan në kinema.

Ata kanë kikirikë.

2. Lidh me shigjetë dhe plotëso fjalët me rrokjet:

ka

ki

ke

ku




___ tri



___ mioni







___ tara



___ bi

3. Gjej fjalë:



4. Lexo: Katër këmbë
ka kali i kuq,
katër këmbë
ka dhe maçoku.
A e di sa ka
PINOKU?

Dallo:



5. Lexo dhe shkruaj sipas modelit:

Unë kam



kam

Ti ke



Ai ka



Ne kemi




Ju keni



Ata kanë




6. Ngjyros.






Obobo, iku ora!
O robot, çfarë ka ora?




O ra mbe ti e gjo ra.

1. Lexo dhe vizato:



2. Krijë fjalë:



3. Luani në role.

Olsi, sa është ora?

Ora është 10.



Oh, harrova

Ronën në kopsht!

Obobo, Ola,
po të pret motra.

4. Gjej fjalët: rosa, lopa, limon, molla.



l	o	p	a	k	n	l	r
i	r	o	s	a	m	i	l
m	o	ll	a	l	o	m	o
o	s	d	e	i	ll	o	p
n	a	n	o	s	a	n	a

5. Lidh fjalitë dhe shkruaji:

Elona

kalon

orë.

Roboti

mori

motrën.

Ola

ka

urën.



Tring - Tring



Unë jam teta Teuta.



Te le fo ni
A lo



te ta Te u ta

1. Shkruaj shkronjën T (t).



LOPA _ A

lopa _ a



_ OPI

_ opi



_ UNELI

_ uneli

2. Lexo:

Teuta
irana
etova

pa**t**a
te**t**a
lo**t**i

3. Lidh rrokjet dhe shkruaj fjalët:



4. Lidh me shigjetë:



5. Luaj në role.

Taulanti në Tiranë

- Taulant, ku ishe të shtunën?
- Udhëtuam nga Prishtina në Tiranë.
- Me tren?
- Jo, me tren. Me veturë.
- E kalove tunelin?
- Po. Tuneli ishte shumë i gjatë.

6. Rretho përgjigjen e saktë.

a. në Tetovë

a. me tren

a. tri tunele

b. në Tiranë

b. me veturë


b. një tunel

7. Ngjyros.

TETOVA



Ana piktoe po pikturon.
 Ana pikturon Rokin.
 Roki e pëlqen pikturën.



1. Shkruaj shkronjën P (p).



5

_ U L A

_ U _ L A

_ I L O T I

_ E S A

_ u l a

_ u _ l a

_ i l o t i

_ e s a

2. Gjej përgjigjen e saktë:



PO

JO

Cili ka shputa? Rretho:



3. Lexo:

Petriti **prapa** pemës.

Pranvera **para** pemës.

Petriti **pranë** pulës.

Pula **poshtë** pemës.



4. Shkruaj:

Pali **prapa** derës.



Macja _____ shkallës.



Dhelprat _____ nënës.



Pema _____ dritares.



5. Lidh fjalinë dhe shkruaje.


Petriti

pa

pushim

punon

6. Ngjyros.





Sot kemi supë.




Su pë



- Supa është me perime.
- Ua, sa supë e mirë!
- Po nesër, do të kemi supë?
- Jo nesër, pasnesër.

1. Rretho dhe shkruaj fjalët:



2. Lexo dhe dallo:

Vajza quhet **Sirenë**.



Sokoli dëgjon **sirenën** e anijes.



Sirena pikturon **sirenën**.



3. Shkruaj dhe ngjyros:



sy i zi

_____ i kaltër

_____ kafe



_____ i gjelbër

4. Lidh etiketat dhe shkruaj fjalinë.





5. Shiko figurat dhe plotëso fjalët me rrokjet **sta, sto**.



H h




- Helikopteri!
- A ka helikopteri helikë?
- Po, ka he

He li kop te ri



1. Plotëso H (h).



2. Rretho fjalën hark.

harabelharkherëhotharmharkhopaharkharkhap

3. Lexo dhe rretho.



Hunda e Pinokut

e gjatë

e shkurtër



Hekuri

i nxehtë

i ftohtë



Hapi

i vogël

i madh


4. Krijë fjali.

Luli

Lopa

Bubi

ha



Nëna

Luani

Mësuesi

hap



5. Ngjyros.

HËNËNA



Sh

sh




Shkolla ka shumë shkallë.
Sa shkallë ka shkolla?
Shkolla ka shtatë shkallë.

Shokët e mi.

Në shkollë kam
shumë shokë.
Sa shokë ka Luli?



1. Rretho **Sh** (**sh**).



2. Krijo fjalë:

s	h	ë
s		e
s		i
s		a
s		u
s		o

shëtis _____

3. Mëso vjershën:

Tre shokë jemi,
tri çadra kemi,
mushama veshim
nëpër shi qeshim.
Shi, or shi,
mos pusho tani,
bjer ti pa pushim
shi, shi, shi
porsi melodi.




4. Rretho grupet e bashkëtingëlloreve **shk** dhe **shkr**. Lexo shpejt.

Shkëlqimi shkon në shkollë.
Shkrimtari shkruan.
Peshkatarari peshkon.



5. Plotëso fjalëkryqin.



		2			6
1	P	SH			Q
					SH
	3	I	SH		
	5	SH		U	




1. Lexo shkronjat:



2. Vendos fjalët në tullumbace. Ngjyros klounin.

pata, Rinori, luan, pi, pula, Luli, ha, kali, Teuta, luani,
patate, Shpresa, punon, limon, perime, karota.







B **b**



Babi, **b**abi!
Jemi në **b**alonë!

Babi dhe roboti bënë balonë.
Ana, Luli e Bubi hipën në balonë.
Balona u ngrit lart.

1. Lidh dhe shkruaj:



2. Lidh fjalitë me figurat.

Bie borë.




Brrr! Sa borë!



Besmiri skijon.



3. Shqipto dhe rretho **mb** dhe **bl**.



4. Luaj në role:

Sot



Nesër



- Teta Besa, ka banane?
- Po, Blerta. Sa do?
- Katër banane.
- Urdhëro.
- Faleminderit, teta Besa!

- Teta Besa, ka banane?
- Jo, Besa më vjen keq.
- Mbaruan?
- Po. Bananet mbaruan.
- Mirë, teta. Faleminderit!

5. Lidh me shigjetë dhe shkruaj në fletore:

Beni

Bubi

Bleta

bën

ham-ham.

mjaltë.

ushtrimin.



JAVA



- E hënë → Unë **jam** në shkollë.
- E martë → Ti **je** në shkollë.
- E mërkurë → Ai (ajo) **është** në shkollë.
- E enjte → Ne **jemi** në shkollë.
- E premte → Ju **jeni** në shkollë.
- E shtunë → Ata **janë** në park.
- E diel → Unë, ti, ai dhe ajo **jemi** në park.

1. Plotëso J (j).

ma _ muni



_ elek

u _ ku



go _ ë e madhe

m _ ellma




u _ ë

2. Shqipto dhe rretho.

- pj** → pjeshkë, pjatë, pjepër
- fj** → fjalë, fjali, fjollë
- mj** → mjalti, mjaullin, mjelma
- kj** → kjo, rrokje, pjekje

3. Luani në role.



Jeta: Alo, Jeton, ti je?

Jetoni: Po, Jeta, unë jam. Si je Jeta?

Jeta: Mirë jam, Jeton. A do të jesh në bibliotekë këtë javë?

Jetoni: Po, patjetër.

Jeta: Sa mirë!

Jetoni: Këtë javë do të mësojmë bashkë.

Jeta: Ditën e mirë, Jeton.

Jetoni: Ditën e mirë, Jetë.

4. Lidh me shigjetë.



makina

ime

jote




macja

jonë

juaj

5. Shkruaj poshtë figurës fjalën e duhur: **janar**, **maj**.





Ua! **F**ustan me **fl**utura!




Fu **sta** **ni** **me** **flu** **tu** **ra**

Sot është festa e fëmijëve.
Ana veshi fustan me flutura.
Roboti i uroi fëmijët për festën.

1. Lidh me shigjetë.

fa fi fu fo fë



2. Plotëso **fl** dhe shqipto:

__ akë __ amur __ utur __ etore
__ okë __ etë __ ori __ as

3. Lexo:

Fëmijët kanë frikë nga fantazma.

Flori nuk ka frikë nga fantazma.

Flori ka mik fantazmën Fufu.

Fufuja e do fort Florin.




4. Krijo fjali.



5. Dallo:



6. Ngjyros.





Dikur bota ishte ndryshe. Dielli ngrohte më shumë.

Në tokë jetonin dinozaurët. Ata ishin të ndryshëm.

Disa hanin mish, disa hanin bimë.


I. Rretho shkronjën (d). Shkruaj fjalë.

d e t d n t i sh d l e
m k d sh ll o r k th b t
h e r e ll a s dh




d i

2. Plotëso:



3. Shqipto dhe rretho.



4. Krijë fjalë sipas modeli.



5. Lidh rrokjet dhe formo fjalë.



Dh dh



Ana: Sa shumë dhurata! Dhoma ime është plot dhurata.

Roki: Kjo është dhurata ime.



Ana: Ua! Një



Roki: Kujdes, Ana, dhelpra është dinake!

Ana: Jo, jo Roki. Kjo është dhelpër lodër.

1. Plotëso **Dh** (**dh**).

D + H = DH	BARD _ A	KËRPUD _ A	UD _ A
D + h = Dh	D _ urimi	D _ ora	D _ urata
d + h = dh	d _ ia	d _ jeta	d _ ëmbi

2. Plotëso **dh**. Lidh me shigjetë sipas kuptimit.

__ elpra


__ ia

__ jeta


dar __ a

dhe

9





3. A kanë kafshët dentist?
Çfarë shikon në figurë?



4. Plotëso:

Dhuratës i dhemb  dhëmbi _____

Ajo shkoi te  _____
 _____ ka shumë frikë.

 _____ nuk ndien dhembje.
 _____ u shërua.

5. Shkruaj përgjigjet.

Sa kërpudha ka në bar?

Në bar ka _____



Sa dhëmbë ke ti?





Sa dardha ka në pemë?



Gara filloi. Babi mat kohën. Luli dhe Bubi janë në krye. Lulit i ngatërrohen këmbët. Ai mbetet prapa. Ana del përpara. Roki gabon dhe ngec në një gropë. Ana e ndihmon. Ata dalin nga gara. Bubi fitoi garën.

1. Plotëso (g).



_ ërshërë _ omë de _ ë _ otë _ oxhdë

2. Lidh dhe krijo fjalë.

ng
 roh ujin _____
 rin _____
 ul _____
 as _____

3. Vendos gr. Lexo fjalët.

__ ip __ ua
 __ ep __ opë
 __ up __ erëz

4. Mëso fabulën.

GOMARI DHE UJKU

Gomari po rrinte në lëndinë.

Aty u afrua ujku.

- Oh, më ka hyrë një gozhdë, - tha gomari.

- Dale ta shoh! - i tha ujku.

Gomari ngriti këmbën.

Ai goditi ujkun në gojë.



5. Rretho fjalën e saktë.



i gëzuar
e gëzuar



i gëzuar
e gëzuar



i gëzuar
e gëzuar

6. Shkruaj fjali në fletore duke bashkuar etiketat.

Agimi ishte një guaskë.
breg. në Atje gjeti

7. Ngjyros.

GOSTIVARI

Gj

gj



Roki: Çfarë janë këto?

Ana: Gjethet e gjelbra të trëndafilit.




Roki: Po këto?

Ana: Gjemba. Oh, më shpuan gishtin! Më doli gjak.

Roki: Gjak! Po mua?

Ana: Ti nuk ke gjak. Unë dhe Bubi kemi gjak.



Gjaku është i kuq.

1. Bashko g + j. Lexo fjalët.



g _ eli



_ jyshe

6

g _ ashtë



_ jarpër

60

_ jashtëdhjetë



g _ u



g _ ysh



_ juhë

2. Vendosi fjalët e mësipërme në tabelë (në fletore).

njerëzit	pjesët e trupit	kafshët	numrat
----------	-----------------	---------	--------


3. Mëso vjershën.

Gjuha jonë sa e mirë,
sa e ëmbël, sa e gjerë
sa e lehtë, sa e lirë
sa e bukur, sa e vlerë.

(Naim Frashëri)



4. Rretho fjalën e duhur.



i gjelbër
e gjelbër



i dashur
e dashur



i gjelbër
e gjelbër



i dashur
e dashur

5. Lidh me shigjetë dhe lexo.



e gjerë

i gjatë





e ngushtë

i shkurtër




6. Shkruaj mbi gjarpër fjalinë:
Gjarpri gjarpëron.





1. Lidh:




2. Ngjyros me të njëjtën ngjyrë rrokjet e të njëjtës fjalë.

Luani
Flutura
Lejleku
Bufi
Delfini
Gaforrja
Bleta
Gomari
Rosa
Kanguri
Peshku
Lopa
Gjarpëri
Dhelpra

ta	Lu	fi	Lej	fo	Flu
le	ri	Dhel	ri	a	Lo
sa	tu	ma	Ro	ra	Ble
rrja	ri	shku	ni	Ga	ni
Go	ngu	ku	Bu	Gjar	Ka
Del	pa	pë	fi	pra	Pe

Shkruaj disa prej tyre në fletore.

3. Zgjidh fjalën e duhur dhe plotëso:




Unë _____ Roki. (jam)
Jetoj në shtëpinë (Lulit)
e _____ dhe _____. (Anës)
Ata kanë dhe _____. (Bubin)
_____ e tyre janë (prindërit)
_____ të mirë me (shumë)
mua. Dhe _____ e (shokët)
shkollës më _____. (duan)
shumë. Më pëlqen të ha (akullore)
_____ dhe të luaj (top)
me _____. Unë tani (flas)
_____ mirë.

4. Plotëso dhe lexo:

- Do _ a ka p _ së gi ___ ta
- Flu _ ur _ ka k _ _ hë.
- Ba _ ai me Ro _ in bën _ balon _.
- Un _ i b _ j m _ sim - t me ku _ des.

5. Plotëso:

Mua më pëlqen _____ .
Shokët e mi janë _____ .



Luli: Sa llasticë je, o Ana!

Ana: Ti je topolak!

Roki: Bu bi lla pu shi !

Ana e Luli: Ti je llafazan.

Të gjithë qeshin.

1. Shkruaj:

Luli → topolak _____


Bubi → _____

Ana → _____

Roki → _____


2. Plotëso fjalët që thotë papagalli:

m _ _ ë




_ _ _ b _ _

s a _ _ a _ _



u _ _ i

_ k _ ll _ _ _



p _ r _ _ k _ _

m _ e _ _ m _



k _ r m _ _

3. Dallo I nga II . Mëso përmendsh vjershën.

Llore-llore akullore,
Llore-llore topa bore,
Lluli, Lulli, oh, ç'gabim,
Luli, Lulëzimi miku im,
akulloren kolofit.
Ah, me falni, prapë gabova,
akulloren kollofiti
që të gjithë i çuditi.
Lore-llore, akulore,
oh, moj ll ç'më ngatërrove
dhe më le pa akullore.



4. Lidh dhe lexo fjalitë.



librash



lodrash

ll
lloj - lloj

5. Vendos X te fjalët që nuk duhen.

Llokumi është: i bardhë, i fortë,
 i kripur, i butë,
 i ëmbël, i thartë.





Roki: Ua, shikoni, ura me ngjyra!

Luli: Është ylber, nuk është urë.

Ana: Luli, kaloje ylberin.

Luli: Jo, nuk dua të bëhem vajzë.

Ana: Sa mirë është të jesh vajzë!

1. Plotëso **y**.

Ngj _ rat e nat _ rës

janë të ndr _ shme.

Ngj _ ros gj _ smën.



2. Lexo dhe shkruaj:

Y	lli	f	elli
	llka	g	pi
	lberi	d	lli

3. Plotëso:

_ _ ze

f _ t _ rë

4. Lexo dhe mëso vjershën.

Yjet dhe hëna

Sa e qeshur hëna,
në netët verore,
një yll i rri pranë
në çaste gazmore.

Hëna porsi nuse,
me shumë bukuri
përreth shikojnë yjet
dhe qeshin si fëmijë.



5. Plotëso.



lapsi yt



libri _ _



babai ynë




qeni _ _ _

6. Shkruaj në fletore dy fjali me **yt** dhe **ynë**.

7. Ngjyros.

Activity for coloring the letter 'y'. It features two groups of circles containing lowercase 'y' and uppercase 'Y'. To the right is a large outline of the uppercase letter 'Y' for coloring, and below it are two small circles, one with a lowercase 'y' and one with an uppercase 'Y'.







Të gjithë po shikojnë filmin “Ana flokëkuqja”. Papritur Roki tha:
- Ana jonë, si Ana flokëkuqja.



Quhet Ana
me flokë të kuqe
e qeshur



1. Krijò fjalë.



Unë _____

Ti _____

Shoqja ime _____

Gjyshi im _____

2. Rretho p ose q.

p → ula
 q

p → epa
 q

p → ylli
 q

p → afa
 q

3. Rretho **fiq**, **miq**.

f i k u f i q m i k u m i q f a q e f i g o m i u m i q f i q m e m i q k i q

4. Mëso vjershën.

Qukapik, o qukapik,
të kam shok e të kam mik.
Pik-pik-pik! Ç'po bën kështu?
- Gëlltis krimba dru më dru.
- Qukapik, o qukapik,
ç'i bën krimbat, more mik?
- I çukis unë pik-pik-pik,
ndaj më quajnë qukapik.



5. Shkruaj poshtë figurave.




miq




fik



7. Ngjyros.



6. Qarko fjalën e shkruar si duhet.



çepa

qepa



çershi

qershi

Rr

rr



Ana dhe Luli shkuan te rrobaqepësi.


- Ta marrim Rokin? - pyeti Luli.

Fëmijët e morën Rokin me vete.


Rrobaqepësi i mati me metër fëmijët.

- Po mua? - pyeti Roki.

- Unë nuk bëj rroba për robotët, - qeshi rrobaqepësi.



1. Krijò fjalë dhe shkruaj.



2. Rretho:

djalë → i rregullt
 → e rregullt

klasë → i rregullt
 → e rregullt

3. Mëso gjëgjëzën.

Rrumbullak
strumbullak,
kur e prek
të bën me gjak.
Kush është?



rrumbullak


4. Mëso vjershën.

Vreshti plot me rrush,
Shportat na i mbush,
rrush i bardhë e rrush i kuq
faqet ç'na i skuq.



Ngjyros
rrushin.

5. Krijë fjali.



a. Pirroja harron alfabetin.

b. Djali harron _____



c. Vajza _____



d. Lepuri nuk _____



6. Mëso:



rrufeja



zjarri



rryma
e lumit

rryma
elektrike



Shkruaj këshilla. P.sh.: Kujdes nga zjarri.




Sa cirk i bukur!


Kostumi i palaços është me copa.

Shiko mollën mbi këpucë!

1. Shkruaj C (c).



2. Mëso:



3. Lexo:

Mama Dhia dhe baba Cjapi kanë shtatë keca.
Baba Cjapi është në pyll. Mama Dhia po këshillon kecat.
Ajo do të shkojë në shitore. Kecat u futën në shtëpi.
Papritur erdhi ujku. Kecat nuk e hapën derën.




Sa keca ka
mama dhia?

4. Sa mace ka në këpucë?



Sa mace ka në kuti?



5. Formo fjali me fjalët e etiketave dhe shkruaji.

Genci

bleu

picë.

ciu-ciu?

Cali

Cili

bën

këpucë

të reja.

po ha





Në çajto

Ndriçimi çeli derën e çajtores. Ai ndjeu aromën e çajit të malit.
Në dorë mbante një kuti me çokollata.



- Çka po bëni çuna?
- Po pimë çaj dhe po hamë reçel.
- Shikoni ç'ju kam sjellë.
- Çka ke sjellë?
- Një kuti plot me çokollata.



1. Plotëso (ç):



2. Emërto dhe ngjyros:




_____ shiu

_____ dielli

_____ kampingu

3. Shiko ngjashmërinë. Krijo situata.



4. Lexo bukur. Dallo ç.

A e njeh ti Çlirimin? Ky është një çun çapkën. Çdo minutë e sheh me çamçakëz në gojë: çam-çum, çum-çam.

E hedh çamçakëzin kudo: në klasë, në rrugë, në shtëpi.


Një ditë Çiljetës iu ngjit kapuçi, mësueses çanta, nënës çorapi.

Për ta dënuar, Çlirimin e lidhën me çamçakëz.



5. Lexo pyetjet.
Thuaj përgjigjet.





Mëngjes

Nëna: Luli, vëre shallin dhe kapuçin.

Luli: Jo, jo nuk i vë.

Nëna: Vishu trashë se iku vjeshta. Erdhi dimri.

Luli: Nuk kam të ftohtë.

Drekë

Luli: Olele veshi!

Roki: Çfarë të ka veshi?

Luli: Veshi, o i shkreti vesh!

Roki: Pse nuk ua vë veshin fjalëve të nënës? Pse nuk e vë shallin dhe kapuçin?

1. Plotëso V (v). Lexo fjalitë.

V arka
me _ ela
_ alëzon
mbi
_ alë.

_ esa
këputi
një _ jollcë
me
_ esë.

_ albona
_ uri
_ athët
në
_ esh.

_ egimi
është
_ ëllai
i
_ erores.

2. Plotëso fjalën vargu. Ngjyros veturat me të



..... i veturave



_____ i patave

Viu-viu fryn veriu

Nëpër xhama troket shiu,

Viu-viu era s'ndalet,

bora zbardhi gjithë malet.

_____ i vjershës

3. Lexo:

Vetoni ka një kuti me vegla pune.
Atë ia dhuroi gjyshi Vehbi për Vitin e Ri.
Veglat e punës janë të vogla. Aty ka një
çekiç, një çelës, një pincë, disa kaçavida
dhe një metër.



4. Lexo dhe dallo ndryshimin.



Pemët **vishen** në pranverë.



Pemët **zhvishen** në vjeshtë.





Visari **zhvishet** në verë.



Valbona **vishet** në vjeshtë.

5. Ngjyros.





1. Shqipto:

ZANORE

A	I	U	
E	Ë	O	Y

BASHKËTINGËLLORE

M	R	N	L	K	T
P	S	H	SH	J	B
F	D	DH	LL	V	Q
RR	G	GJ	C	Ç	

2. Ngjyros me të kuqe zanoret dhe me të kaltër bashkëtingëlloret.

P	h	g	L	V	O	R	T	Ë	M	U	a
E	y	Y	e	i	V	m	A	Ç	O	e	J
K	b	a	RR	S	C	ë	t	dh	sh	a	d

3. Plotëso fjalëkryqin.



4. Duke bashkuar shkronjat gjej emrat e qyteteve.

SHKUPI	SH	P	S	D	I	B	R	A
TETOVA	T	K	R	O	K	L	E	V
KUMANOVA	I	E	U	I	T	M	S	O
PRILEPI	P	C	T	P	L	N	NJ	N
DIBRA	I	R	H	O	I	E	A	A
OHRI	R	M	N	O	V	L	P	M
SHTIPI	S	T	R	U	G	A	T	U
VELESI	I	S	E	L	E	V	R	K

Shkruaj ato që gjete:

SHKUPI

Shkupi,

VELESI

STRUGA

5. Formo nga një fjali për çdo figurë.

1.



2.



1. _____

2. _____

NJ

nj

1

Nje ri



Ana: Dje në cirk kishte shumë njerëz.

Luli: Kishte dhe shumë kafshë.

Bubi: Ham, ham.

Roki: Unë nuk pashë asnjë robot.

Ana: Të pëlqen të jesh njeri?

Roki: Po, më pëlqen të jem njeri.

Ana: Ti je miku ynë.

Bubi: Ham.

1. Plotëso.

nj

një

njo

fto ___

as ___

___ ftim

pe ___

shkro ___

___ ftoj

ulli ___

mushko ___

___ llë

kalli ___

shqipo ___

___ llos

2. Vendos në fjali **asnjë një disa** .

Në kopsht nuk ka _____ fëmijë.

Në kopsht ka _____ dre.

Në kopsht ka _____ pemë.



3. Sa kafshë ka te figurat?



një

1 **10 + 1**



__ __ mbëdhjetë



10 + 10

__ __ zet



100

__ __ qind

4. Lexo dhe ngjyros:

Në figurë është një pemë, një ulëse dhe një urith. Në pemë ka njëmbëdhjetë mollë. Nën tokë janë rrënjët e pemës. Ulësja nuk ka rrënjë. Urithi është në tokë, pranë rrënjëve.



Shëno me ✓

Ku janë rrënjët? në mbi tokë.
 nën

5. Plotëso fjalitë:

- a. Njelma njihet
- b. Njomëza njom
- c. Manjola njollos

Th

th



Thumbi i bletës

- Sa më hahet mjaltë! - tha Luli.
- Eja të marrim, - tha Roki dhe futi dorën në koshere.
- Mos! - thirri Luli. Nga kosherja dolën disa bletë.
- Oh, ç'më thumboi bleta!
- Largohuni, - thirri Roki dhe bletët e rrethuan atë.
- Mua nuk më bën gjë thumbi i bletës, - qeshi Roki.

1. Plotëso th.




__ ikë
__ embër
__ ana

__ em
__ ëllzë
__ upër

__ arëse
__ yej
u __ ull

gje __ e
__ oi
rre __ oj

2. Grupoji fjalët e mësipërme.



3. Lexo dhe rretho **Th** ose **th**. Dëgjo dhe përsërit.

Thuprat e bashkuara

Babai u tha djemve:

– A i thyeni dot këto thupra njëherësh?

Djemtë nuk i thyen dot.


Kur i ndanë veç e veç, i thyen lehtë.

Babai u tha: “Bashkimi bën fuqinë.”



Sami Frashëri

4. Krijò fjali me thur.



5. Lidh me shigjetë. Shkruaj në fletore.



i thartë
e thinjur



e thyer
i thellë




6. Lidh me shigjetë fjalët dhe shkruaj fjalitë.

Bebi
Bleta

thith

biberonin.
nektarin.



- Ua, shikoni, një yll që lëviz! - tha Roki.
- Nuk është yll, është xixë, - tha Luli.
- Nuk është xixë, është xixëllonjë, - qeshi Ana. - Natën xixëllonjat xixëllojnë shumë.
- Pse nxitojnë xixëllonjat? - pyeti Roki.
- Që të mos i kapim, - tha Ana.
- E kapa një xixëllonjë, - thirri Luli. Ai ia ngjiti xixëllonjën Anës në ballë.
- Tani u bëre vajzë me yll në ballë.
- Sa bukur!

1. Shkruaj X.

le _ oj

_ i _ ëllon

n _ itoj

le _ im

_ i _ ëllonjë

n _ itim

2. Shqipto dhe dallo.

nxë

xixë

lex oj

nxë nës

xixë llon

lex im

xixë llonjë

3. Lexo:

Nëna e Guximit po pjek bërçolla. Qeni Xen nxjerr kokën nga kasollja dhe nuhat. Afrohet me guxim dhe rrëmben një bërçollë të nxehtë. Nëna e Guximit nxehet dhe e ndjek pas.



4. Lidh me shigjetë. Lexo fjalitë.

Unë **lexoj** përrallën.

Ti **lexon** tekstin e shkollës.

Ai **lexon** revistën.



5. Lidh me shigjetë dhe shkruaj në fletore.




i nxehtë
e nxehtë



i nxehtë
e nxehtë

6. Ngjyros me të verdhë ku shikon x.



Xh

xh



- Kjo është **xhungla**, - tha Luli.
- Çka është **xhungla**? - pyeti Roki.
- Një pyll i dendur në vende të nxehta, - tha Ana.
- Kafshët **e xhunglës** janë të egra, - tha Luli.
- Ham, ham, - lehu Bubi.
- Po Bubi pse nuk rri **në xhungël**? - pyeti Roki.
- Sepse Bubi është kafshë e butë shtëpiake.

1. Çka sheh në vizatim? Shëno me ✓.

- | | | | |
|----------------------------------|------------------------------------|--------------------------------|-----------------------------------|
| <input type="checkbox"/> luan | <input type="checkbox"/> mace | <input type="checkbox"/> tigër | <input type="checkbox"/> krokodil |
| <input type="checkbox"/> gjirafë | <input type="checkbox"/> majmun | <input type="checkbox"/> dele | <input type="checkbox"/> elefant |
| <input type="checkbox"/> gjarpër | <input type="checkbox"/> peshkaqen | <input type="checkbox"/> gomar | <input type="checkbox"/> flutur |

2. Shkruaj **Xh** (**xh**).

__ upi i __ imit

__ ami i dritares

__ aketa e __ a __ ait

o __ aku i fabrikës

zin __ iri i __ inseve

pan __ ari i sheqerit

3. Mëso vjershën:

Xhepi i fshehtë i Xhimit

Xhimi ka një xhep të fshehtë ku mban xhinglat e tij, ndonëse i vogël vërtet, ai nxë sa e gjithë shtëpia.



Aty gjen bilbila e lapsa, xhama e tapa shishesh, çelësa, gogla e kopsa, zinxhirë e fara pishe.

4. Shkruaj si duhet fjalën **xham**.

_____ i dritares është i pastër.
Vajza shikon nga _____ i dritares.
Në _____ e dritares bie shi.




5. Kujto përrallat. Shkruaj nga një fjali.

Borëbardha dhe shtatë xhuxhat




Tomi dhe Xherri





Zemra



Luli: Ne të duam me gjithë zemër.

Roki: Edhe unë kam zemër. Ja zemra ime.

Ana: Edhe ti e paske zemrën e kuqe!

Bubi: Ham! Ham!

Të gjithë: Edhe Bubi ka zemër.

1. Shkruaj fjalën e duhur.





mirë

bardhë

butë

zemërmirë

2. Plotëso Z (z). Lexo.



3. Lidh me shigjetë. Dallo.

mbush

zgjohem

mbuloj

zbres

fle

zbraz

hip

zbuloj

4. Lexo.

Zakonisht të dielën zgjohem vonë. Nga dritarja vijnë zërat e zogjve. Nga kuzhina dëgjohet zëri i televizorit. Zilja e telefonit bie papritur. Zbres shkallët dhe kap telefonin. Dëgjoj vetëm muzikë, asnjë zë.

- Alo, alo.

Shoqja ime, Zana, e ka zakon të më përshëndesë me muzikë.



5. Plotëso. Vazhdo lojën me gojë.

0 Zeroja është asgjë.

0 _____ pas 1 bën

0 _____ pas 2 bën

0



6. Lidh me shigjetët. Shkruaj fjalitë.



ZEBRA

me vija
e zbukuruar
e zbutur
e gëzuar
zebra
zana
zemërbardhë
bardhezi



ZEBRA

Zana është e zbukuruar,
Zebra është me vija,



Luli tregon:

- Unë jam zhytës shumë i mirë. Vjet në plazh unë mësova të zhytem. Zhytja është një sport zbavitës. Unë veshja kostumin e zhytjes. Vura maskë në kokë dhe lopatat e notit në këmbë.

Oh, ç'mrekulli ishte në thellësi të detit! Kur dola, dallgët përplaseshin me zhurmë në breg.



- Çfarë pa Luli në fund të detit?
- Ngjyros figurat pa ngjyrë.

1. Shkruaj shkronjën e duhur.

- Qyteti ____ urmon nga ____ urma.
- ____ aba ____ ytet në ujë.
- Plaku i varfër ishte veshur ____ ele - ____ ele.
- ____ ana e vari pikturën në go ____ dë.

2. Shiko figurat dhe lexo.

Maçoku Zhak



Zhaku është i veshur.

Ai zhvesh rrobat.



Zbath çizmet.

Futet i zhveshur në vaskë.

3. Përgjigju.

Sa varëse ka në mur?

3

5

4

Çfarë zhveshi në fillim?

kapuçin

shallin

bluzën

Ku i vuri dorezat?

në varëse

mbi çizme

në xhep

Ku u zhyt?


në lumë

në vaskë

në det

4. Shkruaje vjershën në fletore.

Më pëlqen të shkarravis,
mace, zhaba e zhapikë,
po kur bie shumë shi
ata zhduken për çudi.



1. Plotëso

ZANORET

A			

BASHKËTINGËLLORET

P					
		DH			

2. Kush është më i zoti?

Bashko rrokjet dhe gjej emrat e frutave. Shkruaji.

Molla

Dardha

Qershia

Pjeshka

Kajsia

Kumbulla

Limoni

Banane


Mo	na	Kaj
shka	Pje	mbu
shi	lla	si
Dar	a	mo
Ba	Li	lla
Ku	dha	ne
ni	Qer	a

3. Lidh në bazë të rimës.

fushë	farë	molla	kokë	lidh	limon
garë	kolla	gushë	zgjdh	timon	tokë

A red arrow points from the word "fushë" in the first row to the word "gushë" in the second row.

4. Emërto pjesët e trupit të njeriut.



5. Gjithçka rreth teje.

- Kush je ti?
- Cilët janë miqtë e tu?
- Fol për librin që të pëlqen më shumë.
- Fol për sportin që ndjek.
- Të pëlqen më shumë muzika, vizatimi apo kërcimi?



EJA

TEK

UNË



Vajza dhe ujku



Na ishte një herë një vajzë e vogël. Ajo nuk kishte shëtitur asnjëherë në pyll. Aty jetonte ujku.

Një ditë vajza e vogël shkoi në pyll. Aty pa një lule të bukur. U ul nën pemë dhe filloi të këndonte:

“A B C Ç D DH E Ë F G GJ H I J K L LL...”

Por aty ishte ujku.

- Vajzë e vogël, - i tha Ujku, - vazhdoje atë këngën e bukur për mua.

- M

N

NJ

O

P

Q

R

RR

S

SH

- këndoi vajza e vogël me gjysmë zëri.

Ujkun e zuri gjumi.

Vajza e vogël vrapoi shpejt: çap e çup, çap e çup!
 Ujku u zgjua. Ai vrapoi dhe e zuri vajzën e vogël.
 - Vajzë e vogël, - i tha Ujku, - vazhdoje atë këngën e bukur për mua.
 - T TH U V X XH Y Z ZH, - këndoi vajza e vogël me gjysmë zëri.
 Ujkun përsëri e zuri gjumi. Kur u zgjua e arriti vajzën.
 - Vajzë e vogël, vazhdoje atë këngën e bukur përsëri.
 - Mbaroi o ujk, - i tha vajza. – Kaq ishte.
 - Të lutem, filloje nga fillimi, - iu lut ujku.
 - a b c ç d dh e ë f g gj h i
 j k l ll m n nj o p q r rr s sh
 t th u v x xh y z zh .
 Që nga ajo ditë vajza e vogël mblidhte lule në pyll. Ajo këndonte:
 A B C. Ndërsa ujku e dëgjonte i kënaqur.



1. Si mendon, pse ujku u bë i mirë?
2. Gjej një melodi dhe këndo me të alfabetin.
3. Pse ndryshon ky ujk me ujkun e Kësulëkuqes?



Kërmilli dhe miu

Një kërmill po shëtiste në fushë. Ai mbante mbi shpinë shtëpizën e tij. Tek zvarritej, ai takoi miun. Miu i habitur nga ajo që pa, i tha me tallje:

- Sa i marrë që je, mor torollak! Ç'të duhet ta mbash në shpinë shtëpizën? Nuk të rëndon ajo?

Kërmilli nuk foli, por vazhdoi rrugën, pa ua vënë veshin fjalëve të miut.

Pas pak filloi të binte shi. Kërmilli i mençur u strehua në shtëpizën e tij. Ai mbylli dyer e dritare. Ndërsa miu i gjorë u bë qull nga shiu.



1. **Ku** po shëtiste kërmilli?
2. **Kë** takoi ai rrugës?
3. **Pse** e talli miu kërmillin?
4. **Çfarë** ndodhi kur filloi shiu?

Ngjyros kërmillin.



Koha ikën

Koha ikën e shkon,
Tik-tak, tik-tak, tik-ta...
Një sekondë,
një minutë,
një orë.
Rruga e saj ende vazhdon.
Rruga e saj ende vazhdon.

Në sahat sheh sa është ora,
ditët numëron në kalendar.
Një javë,
një muaj, një vit.
Koha fluturon
pa u ndalur aspak.



1. Ku tregohen ditët, javët dhe muajt?

.....

2. Ku tregohen sekondat, minutat dhe orët?

.....

3. Përpiqu të bësh prej kartoni tri orë të tilla:

E para të tregojë orët.



E dyta të tregojë ditët e javës.



E treta të tregojë muajt e vitit.



Tigri që vrapon



Tigri i vogël është i mërzhitur. Nëna e tij ka dalë për gjah. Ajo e ka porositur tigrin të mos largohet nga shtëpia.

Po tigri dëshiron të luajë. Papritur sheh një flutur të bukur.

Ai mundohet ta prekë fluturën, por ajo ikën fluturimthi.

Tigri e ndjek pas dhe humb rrugën! Papritur fillon shiu. Tigri ulet përtokë e qan si një kotele.



Befas dëgjohej një zhurmë! Një elefant i madh po vjen drejt tij.

Tigri vrapon me shpejtësi dhe qan për nënën e tij.

Papritmas dëgjon ulërimën e nënës. Tigri i vogël vrapon drejt saj. Sa i lumtur është që e takoi! Nëna e tigrin e harron zemërimin, që i biri nuk ia dëgjoji fjalën. Të dy bien përdhe duke u përqaftuar. Tigri i vogël ndihet përsëri i sigurt, pranë nënës së tij.



- 1.** Ku është nëna e tigrin:
- në shëtitje në gjah në strofull?
- 2.** Pse humbi tigrin? Po ndiqte:
- zogun lepurin fluturën?
- 3.** Çfarë bënte tigrin, kur sheh elefantin:
- e përshëndet kthehet prapa vrapon?
- 4.** Si ndihet tigrin, kur takon nënën:
- i lumtur i mërziur i zemëruar?



Banja e urithit

I.


Kur urithi mbaroi së gërmuari, ishte shumë i ndotur.

- Më vjen shumë keq, – i tha Xhiku kopshtari, – por nuk mund të hash kështu. Duhet të lahesh.

Urithi u mërzit.

Xhiku mbushi një govatë të madhe me ujë të ngrohtë e me shkumë. Pastaj solli sapun e shampo, sfungjer e furçë për shpinën.

Kur gjithçka u bë gati, nuk e gjeti aty urithin.



1. Pse duhet të lahesh urithi pas punës?

2. Gjej të kundërtat e fjalëve:

i keq

i ndotur

3. Çfarë bën me qejf urithi?

gërmon

ha

fle

lahesh

4. Cilat gjëra vuri xhaxhi kopshtari brenda në govatë?
Shëno X në kuti.



2.

Urithi ishte fshehur. Ai nuk donte të bënte banjë. Xhaxhi Xhiku e kërkoi, por nuk e gjeti askund.

Papritur Xhiku dëgjoi një zhurmë mbi kokën e tij. Ai pa diçka që lëvizte mes gjetheve. “Mos është urithi?” - mendoi. “Jo..., sigurisht që jo! Urithët nuk hipin në majë të pemëve”. Papritmas u dëgjua një KRAK! Një kafshë e madhe ra nga pema drejt e në govatë.



PLLUQ! Uji doli si shatërvan. Xhiku u çudit shumë. Ishte urithi i mbuluar kokë e këmbë me shkumë. I shkreti, tundte kokën! Xhiku u shkri duke qeshur:

- Të lutem, mund të ma japësh pak sfungjerin? – i tha urithi.

Kështu urithi u mësua të lahej.

1. Urithi u la, sepse:

e pëlqen banjën

ra nga pema?

2. Urithi ishte:

mbi pemë

nën tokë.



Nënë

Fatosi s'është ndarë kurrë nga nëna e tij. Kur u regjistrua në klasë të parë, ai u mërzit shumë. Kaluan ditët. Fatosi u mësua me jetën shkollore. Ai mësoi të shkruante vija të pjerrëta, të drejta. Por kjo nuk e kënaqte. Ai donte që të mësonte shumë shkronja, për të shkruar fjalën nënë.



Në fillim arsimtarja u mësoi shkronjën a, i, m, u etj. Mësuan edhe shkronjën N.

Për Fatosin kjo ishte dita më e lumtur.

Arsimtarja shkroi në dërrasë të zezë fjalën NËNË. Fatosi mbeti i habitur.

Prandaj e pyeti arsimtaren:

- A mund të shkruhet fjala NËNË vetëm me dy shkronja?!

Arsimtarja, pasi qeshi pak, i tha:

- Po si jo? Të shkruash fjalën nënë është e lehtë. Aq e lehtë sa ta duash, ta dëgjosh dhe ta gëzosh atë.

1. Pse Fatosi u mërzit kur shkoi në shkollë?

2. Si shkruhet fjala **nënë**:

me dy shkronja me katër shkronja?

3. Çfarë i tha arsimtarja Fatosit?



Babi im

Janë tubuar pesë fëmijë dhe bisedojnë ëmbël e me krenari:

- Babi im është më i fuqishmi në botë. Ai futet në zemër të malit dhe prej andej nxjerr gur, - thotë fëmija i parë.

- Kurse babi im mund të tërheqë me vete tërë ata gurë.

E dini, ai është lokomotivist, - ua kthen fëmija i dytë.

- Babi im është edhe më i fuqishëm. Me makinën e tij, mund të bluajë edhe shkëmbinjtë më të fortë, - nxiton të thotë fëmija i tretë.

- Babi im është trim me fletë. Ai ngjitet mbi malet.

Babai im është pilot, - shton fëmija i katërt.

- Për mua, - thotë fëmija i pestë, - nuk ka rëndësi se ç'punon babi im. Kur ai më ngre deri në tavan, unë shoh krejt botën: edhe fushat, edhe malet, edhe zogjtë, edhe aeroplanët...

Atëherë jam më i lumturi...



1. Si mendon ti: cili është babai më i fuqishëm:

ai që jep shumë dashuri ai që ka profesion të veçantë?

2. Lidh me shigjetë:

Njeriu që nxjerr gurë nga mali

Njeriu që nget trenin

Njeriu që rregullon dhëmbët

Njeriu që punon me traktor

Njeriu që drejton aeroplanin

Njeriu që këndon

traktorist

dentist

lokomotivist

minator

këngëtar

pilot



3. Ç'profesion ka nëna dhe babai yt?

Skënderbeu

I vogël jam
për ty kam ndi,
si luftove për Arbëri.

Emri yt,
o trim Skënder
n'zemrat tona
jeton përherë.

Trim i mirë
me shumë shokë,
për Ty këndon
qiell e tokë.



1. Çka di ti për Skënderbeun?

2. Si e përfytyron Skënderbeun:

- | | | |
|------------------------------------|------------------------------------|-----------------------------------|
| <input type="checkbox"/> me mjekër | <input type="checkbox"/> të fortë | <input type="checkbox"/> me shkop |
| <input type="checkbox"/> me shpatë | <input type="checkbox"/> me makinë | <input type="checkbox"/> me kalë? |


3. Në luftë kundër armiqve Skënderbeu fitonte se:

- | | | |
|-------------------------------------|--|---|
| <input type="checkbox"/> ishte trim | <input type="checkbox"/> luftonte vetë | <input type="checkbox"/> luftonte me shokë? |
|-------------------------------------|--|---|

4. Mësoje vjershën përmendsh.



Të vegjëlit



Naim Frashëri

Lërimi gjithë të vijnë
të vegjëlit pranë meje.
Ah! Mos i bëni të qajnë
sytë ulur të mos i mbajnë.
Të qeshin, të nxitojnë,
të bredhin e të gëzojnë,
të prehen e të këndojnë,
për të keqen mos mendojnë.
Falu gjithë mirësinë,
të mësojnë dituritë.
Mëmëdhenë ta nderojnë,
Ta lartësojnë e zbukurojnë.

mëmëdhe - atdhe

1. Çka dëshiron poeti për fëmijët?
2. Si uron ai?
3. Çka duhet të bëjnë fëmijët për mëmëdhenë?
4. Cili është mëmëdheu yt?



Lodra e vjetër


I.

Familja e Teutës po shkon në një shtëpi të re. Gjërat e vjetra ata nuk po i marrin me vete. Teuta trembet se mos i hedhin edhe Tedin, arushin prej pellushi. Ajo e ka atë shok të ngushtë.

- Ai është i vjetër dhe i pistë - i thotë nëna.

Vërtet, Tedi nuk është shumë i ri. I mungon një vesh dhe duket si i pakrehur. Atij i janë zbehur edhe ngjyrat, sepse mami e lan shpesh në lavatriçe... Por sytë e tij janë shumë të ëmbël dhe mban erë të mirë sapuni.

Të gjitha gjërat i futën në një kamion të madh.



2.

Shtëpia e re është e madhe dhe e bukur.

Teuta pyet:

- Ku është Tedi?

- Je e rritur tashmë - përgjigjet nëna.

Teuta mërzhitet shumë.

Dy pika të mëdha loti ia lagin faqet. Papritur mami ikën me vrap dhe kthehet te shtëpia e vjetër.

Mes shumë gjërash të vjetra, doli Tedi, i tëri i mbuluar me pluhur. Mami e shtrëngon fort dhe vrapon e lumtur drejt Teutës.

1. Pse u mërzhit Teuta?

2. Çfarë bëri mami?

3. Ke edhe ti ndonjë lodër që e do shumë? Trego.



Aventurat e Gishtos



Na ishin njëherë një grua dhe një burrë që nuk kishin fëmijë. Por sa shumë e dëshironin! Një ditë në kopshtin e tyre mbi një lakër po lëvizte diçka e vogël.

– Ju lutem, mos më lini këtu, – u dëgjua një zë.

U çuditën shumë, kur panë një fëmijë sa një gisht. E morën me vete në shtëpi. Vendosën ta bënë fëmijën e tyre. Pasi u menduan mirë, e quajtën Gishto. Prindërit kujdeseshin shumë për të, por Gishtoja nuk u rrit që nuk u rrit.

Gishtoja ishte shumë gazmor dhe i shkathët. Ai i donte dhe i ndihmonte prindërit, por shpesh harrohej pas lodrave. Madje njëherë Gishton desh e gëlltiti një lopë. Prindërit e shpëtuan. Prej asaj dite ai u premtoi prindërve që nuk do të largohej nga ata. Prindërit jetuan shumë të lumtur me djalin e tyre.

1. Cilat janë personazhet e kësaj përralle?
2. Pse prindërit e quajtën Gishto?
3. Çka i ndodhi Gishtos?
4. Ç'mësime nxori ai?



Semafori

Si rojë qëndroj
në kryqëzim,
me sy flas,
dhe s'lodhem hiç.

Syrin tim blerosh
unë kur ta çel,
rrugën mund ta kalosh
askush s'të shkel.

E kur ta çel t'kuqin
ndalu ashtu si burrat,
pusho, shtrembo kapuçin
se atëher' kalojn' veturat.



1. Ku vendosen semaforët:

- në park
- në kryqëzim rrugësh
- në pyll


2. Ngjyros dhe lidh me shigjetë:



- Kalo!
- Mos kalo!
- Bëhu gati!



Një pasion i madh



Emi e Klea janë shoqe të ngushta. Atyre u pëlqen të lexojnë shumë. Vajzat shkojnë shpesh në bibliotekë. Ato fusin mes librave hundën, sytë, madje të gjithë kokën. Çohen prej aty vetëm kur e mbarojnë të gjithë librin ose kur mbyllet biblioteka. Por Emi dhe Klea janë në shkollë të ndryshme. Emi shkon në bibliotekë të martën dhe të enjten; Klea të hënën e të mërkurën. Vetëm të premtën shkojnë bashkë.

Dy mikeshat pëlqejnë të njëjtët libra. Libri që i pëlqen Emit, i pëlqen edhe Kleas. Libri që nuk i pëlqen Emit, nuk i pëlqen as Kleas. Ndonjëherë të dyja vajzat e vogla lexojnë të njëjtin libër. Kokat e tyre të vogla rrinë ngjitur me njëra-tjetrën mbi libër.

Në fakt, rregullorja nuk lejon që dy lexues të lexojnë njëkohësisht të njëjtin libër. Por teta e bibliotekës bën sikur nuk i vë re. Ajo i do shumë vajzat. Ato janë lexueset më të mira të bibliotekës.

1. Cili është pasioni i Emës dhe i Kleas?

2. Kur shkojnë vajzat në bibliotekë:

- Vajzat shkojnë çdo ditë bashkë në bibliotekë.
- Emi shkon të hënën e të mërkurën.
- Klea shkon të martën.
- Të dy vajzat shkojnë bashkë të premtën.

4. Pse teta e bibliotekës nuk u bën vërejtje vajzave?

5. Ku të pëlqen të lexosh:

në shtëpi

në bibliotekë

në klasë?





Dyqani i lodrave

Nuk kisha parë kurrë një dyqan kaq të bukur! Mua më shkuan sytë menjëherë te vitrina. Ka kaq shumë gjëra të bukura për të parë!

Shoh modele barkash, shoh edhe aeroplanë.

Papritur ua ngul sytë trenave. Afrohem dhe shoh një tren të madh prej druri. Ai ka një lokomotivë me tre vagonë. Lokomotiva është krejt e zezë. Ajo ka një oxhak të madh me formë të rumbullakët. Ndërsa vagonët kanë ngjyra të ndryshme.

- Nëse të pëlqen ai treni, do të ta blej, – më thotë gjyshja.
- Faleminderit, gjyshe, është një dhuratë shumë e bukur!

Kur arritëm në shtëpi, montova rrotat në kopsht. Janë plastike, nuk i prish lagështira. Treni im mund të përshkojë rrugë të tëra e kryqëzime të shumta: treni im vrapon në mes të fushës.

Shkon ndonjëherë të blesh vetëm?

Si sillen me ty shitësit e dyqaneve?

Në dyqan kishte edhe lloje të tjera lodrash:

Videolojë

Aeroplanë e barka

Lodra elektronike

Makina të vogla



Luajeni pjesën në role.

Ruaj një vend për mua

Kafshët në lojë:

Lepuri	Zogu
Miu	Ketri
Ketri i madh	Bretkosa e madhe
Arushi i vogël	Tri bretkosa të mëdha

Koha: - Natë.

Vendi: - Pranë një pellgu me ujë.

(Një lepur qëndron dhe vështron ujin. Një mi vjen ngadalë duke e vështruar atë.)

Miu: - Tungjatjeta, lepur! Çfarë po bën këtu?

Lepuri: - Po ruaj vendin tim.

Miu: - Edhe unë do të ruaj vendin tim.

(Miu qëndron pas lepurit. Një ketër i madh vjen pas tyre dhe i shikon.)

Ketri i madh: - O mi, ti e ke këtë vend?


Miu: - Jo, jo. Ti mund ta zësh atë.

(Ketri i madh ulet pas miut, ndërsa një arush i vogël qëndron ulur pas ketrit.)

Arushi i vogël: - Çfarë po bën, o ketër?

Ketri i madh: - Po ruajmë vendet.

Arushi i vogël: - Po zë edhe unë një vend këtu për të pushuar.



(Një zog vjen dhe shikon kafshët.)

Zogu: - Ka këtu një vend për mua?

Arushi i vogël: - Ti mund të zësh një vend pas meje.

(Zogu zë një vend pas arushit. Një ketër vjen dhe shikon kafshët.)

Ketri: - Po për mua ka një vend të lirë këtu?

Zogu: - Po. Ja, ky vendi pas meje.

(Ketri ulet pas zogut. Një bretkosë e madhe del nga uji.)

Lepuri: - Këtu e ka vendin ajo. Tani është koha për një shfaqje.

(Kafshët rrinë të qeta.)

Bretkosa e madhe: - Tungjatjeta, o miq. Shokët e mi dhe unë do të këndojmë tani për ju.

(Bretkosat e vogla dalin nga uji. Të gjitha bretkosat këndojnë këngën "Zoti lepur".)

Lepuri: Sa shfaqje e bukur dhe e këndshme! Të pëlqeu o mi?

Miu: Po. Më pëlqeu shumë.

Ketri i madh: - Edhe mua më pëlqeu. Do të këndonis përsëri?

Bretkosa e madhe: - Po. Ne do të kthehemi dhe do të këndojmë përsëri. Tani është koha të ikim. Natën e mirë, shokë!

Ketri: Bretkosat ikën. Unë do të iki në shtëpi tani. Ruaje vendin tim, o zog.
(Ketri shkon në shtëpi.)

Arushi i vogël: - Ruaje vendin tim, o ketri i madh.
(Arushi i vogël ikën në shtëpi.)

Ketri i madh: - Ma ruaj vendin tim, o mi.
(Ketri i madh ikën në shtëpi.)

Miu: - Ruaje vendin tim, o lepurush.
(Miu ikën në shtëpi.)

Lepuri: - Unë do të kthehem në mëngjes dhe do ta ruaj përsëri vendin tim.
(Lepurushi shkon të flejë në shtëpi.)



Televizori dhe libri



Rendit ngjarjet e tregimit.



1. Televizori u prish.
2. Babi arush thirri teknikun.
3. Nëna arushë filloi t'i lexonte vogëlushes librin.
4. Kur u rregullua televizori, babi thirri vogëlushen.
5. Por ajo po kënaqej duke lexuar librin.

Tekst kënge

Gjuha e nënës



Kush je ti?
Unë jam Dardani nga Kosova.
Po ti?
Jam Teuta nga Mali i Zi.
Unë jam Agroni nga Maqedonia.
Jam Valbona nga Shqipëria.



Refreni


Ne jemi të gjithë shqiptarë,
flasim të njëjtën gjuhë,
kudo në botë ku shkojmë
gjuhën shqipe nuk e harrojmë.



Shqip, shqipe, shqiponjë
me flatra kuqezi fluturojmë...
Shqip, shqipe, shqiponjë
me flatra kuqezi fluturojmë...



Kush je ti? Ç'gjuhë flet ti?
Unë jam Roki, jam robot.
Të gjitha gjuhët unë i di.
Po si ju fëmijë nuk jam,
gjuhën e nënës nuk e kam.



Përmbajtja

Ditëlindja	4
Viti i Ri	5
Çfarë di të bësh?	6
Lojërat më të bukura	7
Shoqërimi	8
Hija e kafshëve	9
Lojë me numra	10
Bisedë për ndjenjat	11
Xhuxhët dhe Borëbardha	12
Po të qeshin të gjithë fëmijët	13
Miqtë tanë	
Në shtëpi	16
Në dyqan	18
Në qytet	20
Në fshat	22
Roki shkruan dhe lexon	
A	26
M	28
I	30
U	32
R	34

E	36
N	38
L	40
Përsëritje	42
Ë	44
K	46
O	48
T	50
P	52
S	54
H	56
SH	58
Përsëritje	60
B	62
J	64
F	66
D	68
DH	70
G	72
Gj	74
Përsëritje	76
LI	78
Y	80
Q	82
Rr	84
C	86
Ç	88
V	90
Përsëritje	92
Nj	94
Th	96
X	98
Xh	100
Z	102
Zh	104
Përsëritje	106

Pjesa III - Eja tek unë

Vajza dhe ujku (An Dilën)	110
Kërmilli dhe miu (Eroll Veliu)	112
Koha ikën (Marçelo Arxhili)	113
Tigri që vrapon (Derek Hell)	114
Banja e urithit (Përrallë e përshtatur)	116
Nënë (Mustafa Morina)	118
Babi im (Qamil Batalli)	119
Skënderbeu (Ali Huruglica)	120
Të vegjëlit (Naim Frashëri)	121
Lodra e vjetër (Tregim i përshtatur)	122
Aventurat e Gishtos	124
Semafori	125
Një pasion i madh (Entela Janko)	126
Dyqani i lodrave (Jona Mero)	127
Ruaj një vend për mua (pjesë teatrale)	128
Televizori dhe libri	130
Gjuha e nënës	131